



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:048414
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05644402

KPPP.nr.629/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina”, SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit Restorant Liburnia me NUI 810915853, me seli në Prishtinë, Nr.10 Rr. Meto Bajraktari E-0377, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Jeton Osmani avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.29/2021 të datës 22.01.2021, të Përmbaremit Privat Arsim I. Bajraktari, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Sallon Restorant Liburnia, ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr.29/2021, i datës 22.01.2021, i Përmbaremit Privat Arsim I. Bajraktari, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbaremit Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina”, SH.A., ka caktuar urdhrin përmbaremore P.nr.29/2021 të datës 22.01.2021, duke lejuar përmbaremit në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.3467, nga data 01.01.2013 deri me datë 21.01.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin Restorant Liburnia, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,231.40 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore, në të kundërtën përmbaremit të realizohet me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në xhirollogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e

kreditorit, ndërsa nëse debitori nuk ka mjete në llogarinë e tij përmbarimi të realizohet me konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes të autorizuarit të tij ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbarimit me arsyetimin se urdhri për përmbarim është i kundërligjshëm, për shkak të aplikimit të gabuar të nenit 29 par.1 nën par 1.2, nenit 30 lidhur me nenin 21, nenit 70 lidhur me nenin 71 të LPP-së. Ka shtuar se në bazë të nenit 341, 343 dhe nenit 352 të LMD-së, borxhi sipas dokumentit në bazë të cilit është marrë urdhri për përmbarim është parashkruar. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të Anulohet Urdhri Përmbarimor P.nr.29/21, i datës 22.01.2021, i lëshuar nga përmbaruesi privat Arsim I. Bajraktari si dhe ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se e kundërshton prapësimin si të pa bazuar, të pa argumentuar si dhe pa mbështetje në prova. Ka shtuar se e kundërshton pretendimin lidhur me parashkrimin pasi që debitori ka pranuar borxhin e tij dhe një kohësisht ka bërë pagesa të pjesshme, po ashtu debitorit iu kanë dërguar 5 vërejtje me shkrim lidhur me krijimin e borxhit të tij. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta hedh poshtë si të pa bazuar.

Gjykata në ri procedurë duke i pasur parasysh sugjerime dhe vërejtje të Dhomës së Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate sipas aktvendimit me numër K.DH.Shk II.nr.1385/23 të datës 18.03.2024, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.3467, Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit dhe nuk është përfshirë periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që ekstrakti nr. Nr.3467 përfshin periudhën kohore nga 31.12.2013 e deri më datë 01.01.2014 në shumë prej 754.05 EUR, ndërsa në përmbajtjen e ekstraktit, janë të listuara faturat vetëm nga data 31.12.2013 e tutje, ashtu vlera e borxhit prej 754.05 EUR e paraqitur si saldo, nuk dihet se për cilën periudhë kohore është grumbulluar dhe a është njoftuar debitori lidhur me këtë detyrim.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Meqenëse gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të tjera të ngritura nga debitori si në prapësim, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr. 629/24 datë 30.04.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.